



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I QARKUT LEZHE**

---

Nr \_\_\_\_ Prot.

Lezhe me \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2008

Lenda: **Njoftim per zhvillim tenderi**

Drejtuar: **-Agjensise se Prokurimit Publik-  
-TIRANE-**

**Bashkengjitur po ju dergojme per botim ne Buletinin e Njoftimeve Publike “ Njoftimin e kontrates” per prokurimin “Blerje Gjeneratori”**

**KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**-Bardh RICA-**

## **FORMULARI I NJOFTIMIT TE KONTRATES**

**(Kopje e permbledhur e cila do te publikohet ne buletin)**

### **KESHILLI I QARKUT LEZHE**

**1. Autoriteti kontraktor ,adresa,nr tel: Keshilli i Qarkut Lezhe,Sheshi “Gjergj Kastrioti”Lezhe,tel 02152470**

**2. Lloji i procedures se prokurimit : Procedure e hapur**

**3. Objekti i prokurimit( nqs ka lote i ndare sipas loteve): “Blerje gjeneratori”per Keshillin e Qarkut Lezhe**

**4. Fondi limit ( nqs ka lote i ndare sipas loteve):  
**416.667(katerqind e gjashtembedhjetemije e gjashteqind e gjashtedhjete e gjashte)leke pa tvsh****

**5. Afati per kryerjen e sherbimit eshte:1 muaj ose 30 dite nga data e lidhjes se kontrates**

**6. Data e zhvillimit te tenderit,vendi:15/08/2008 ne zyren e Nen/kryetarit te Keshillit te Qarkut Lezhe**

**7.Afati i fundit per pranimin e dokumentave,vendi:15/08/2008  
**Ofertat do te dorezohen ne zyren e Programim Zhvillimit****

**KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
-Bardh RICA-**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI KONTRAKTOR**

**Keshilli i Qarkut Lezhe**

**DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR**  
**KONTRATAT E FURNIZIMIT TE MALLRAVE - Procedura e**  
**Hapur**

**OBJEKTI “Blerje Gjeneratori”**

## **Tabela e Përmbajtjes**

1. NJOFTIMI I KONTRATËS .....	3
2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR PROCEDURËN.....	6
3. UDHËZIME PËR OFERTUESIT .....	10
4. KUALIFIKIMI .....	16
5. VLERËSIMI I OFERTAVE .....	21
6. INFORMACION PËR ANKIMET ADMINISTRATIVE	
NË DISPOZICION TË OPERATORËVE EKONOMIK.....	27
7. NËNSHKRIMI I KONTRATËS.....	28
8. INFORMACION MBI DOKUMENTAT E TENDERIT.....	29
9. SHTOJCAT.....	30

## NJOFTIMI I KONTRATËS

### Seksioni I Autoriteti Kontraktor

#### I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Keshilli i Qarkut Lezhe  
Adresa Sheshi "Gjergj Kastrioti"  
Tel/Fax 02152470  
E-mail qarkulezhe@gmail.com  
Adresa e Internetit [www.qarkulezhe.gov.al](http://www.qarkulezhe.gov.al)

#### I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:

Emri Gjovalin Gjeloşi  
Adresa Sheshi "Gjergj Kastrioti"  
Tel/Fax 02152470  
E-mail [qarkulezhe@gmail.com](mailto:qarkulezhe@gmail.com)

#### I.3 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion qendror	Institucion i pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njesite e qeverisjes vendore	Tjetër
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

### Seksioni II Objekti i kontratës

#### II.1 Lloji i Kontratës

Punë	Shërbime	Mallra
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

Lloji i "Kontratave për punë publike"

Realizimi i puneve

Projektimi realizimi i puneve

**Lloji i ‘Kontratave Publike për Shërbime’**

Konkurs Projektimi

Shërbime Konsulence

Shërbime të tjera

**Lloji i “Kontratave Publike për Mallra”**

Blerje

**X**

Qira

Leasing

Blerje me këste

Një kombinim i tyre

**II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

1. Fondi limit **416.667**(katerqind e gjashtembedhjetemije e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë)leke pa tvsh
2. (Qellimi i kontratës, sasite)

Plotesimi i kerkesave te Keshillit te Qarkut per prodhimin e energjise elektrike per cdo rast nderprerjeje.

**II.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në muaj **1** ose ditë **30**

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

**II.4 Vendndodhja e objektit te kontratës:**

Ne godinen e Keshillit te Qarkut Lezhe

**II.5 Ndarja në LOTE:**

Po

Jo

**X**

*Nëse po,*

**II.6 Përshkrim i shkurtër i loteve**

(Sasia ose synimi dhe fondi limit i LOTEVE)

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

etj\_\_\_\_\_

**II.7 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka):

Ose: nga   në

**II.8 Do të pranohen variantet:**

Po  Jo

**II.9 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër**

Po  Jo

**Seksioni III Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik**

**III.1 Kërkesat per Kualifikim**

**III.1.1 Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë, duke përfshirë kërkesat lidhur me regjistrimin në regjistrat profesionalë ose tregtarë:**

Informacione dhe formalitete të nevojshme për të vlerësuar nëse janë përmbushur kërkesat:

- Vendimi per regjistrimin ne gjykate.
- Liçensa e organit tatimor per ushtrim aktiviteti
- Nipt-i

*Informacione të mëtejshme në dokumentat e tenderit*

**III.1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Informacione dhe formalitete të nevojshme për të vlerësuar nëse janë përmbushur kërkesat:

- Kopje të bilancit per 2007.
- Një çertifikatë të gjendjes financiare jo me pak se 20% te kontrates qe do te realizohe nga nje ose me shume banka (te marre jo me pare se 1 muaj nga data e tenderit).
- Vertetim per xhiro mesatare vjetore gjate vitit 2007 e cila duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se vlera qe konkurron .

*Informacione të mëtejshme në dokumentat e tenderit*

**III.1.3 Kapaciteti teknik:**

Informacione dhe formalitete të nevojshme për të vlerësuar nëse janë përmbushur kërkesat:

---

---

*Informacione të mëtejshme në dokumentat e tenderit*

### III.2 Sigurimi i Ofertës:

Sigurimi i ofertës duhet të jete ne masen 2% ne shumen 8.333(tetemije e treqind e tridhjetë e tre)leke pa tvsh

## Seksioni IV Procedura

### IV.1 Lloji i procedurës:

E hapur	E kufizuar	Me negociim	Konkurs projektimi
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

### IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët X

Ose

B) oferta më e ulët e vlerësuar

lidhur me rëndësinë: Çmimi  ose Cilësia , etj.

*Informacione të mëtejshme në dokumentat e tenderit.*

### IV.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **15/08/2008** (15/08/2008) Ora: **10:00**

Vendi: Zyra e Nen/Kryetarit të Keshillit të Qarkut Lezhe, kati i tretë.

### IV.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **15/08/2008** (15/08/2008) Ora: **10:00**

Vendi: Zyra e Nen/Kryetarit të Keshillit të Qarkut Lezhe, kati i tretë.

IV.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave:  (e shprehur në ditë)

### IV.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht	<input type="checkbox"/>
Tjetër		_____	

## Seksioni V Informacione plotësuese

**V.1 Dokumenta me pagesë:**

	Po	<b>X</b>	Jo	<input type="checkbox"/>
<i>Nëse Po</i>	Monedha	<b>leke</b>	Çmimi	<b>1000</b>

**V.2 Referenca e dosjes, e përcaktuar sipas autoritetit kontraktor:** \_\_\_\_\_

**V.3 Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtën kontratë (nëse zbatohet):**

Buletini i Njoftimeve Publike      Data      \_\_\_\_\_      Numri      \_\_\_\_\_

**V.4 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**

**Dokumentat do të tërhiqen tek zyra e Programim Zhvillimit, Investimeve dhe Marredhenieve me Jashtë duke paraqitur kërkesën me shkrim dhe mandat-pagesën prej 1000 (një mijë) lekë që paguhet tek zyra e financës.**

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **14/07/2008**

## 2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR PROCEDURËN

- 2.1 Procedura e prokurimit publik do të kryhet në përputhje me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, me Rregullat për Prokurimin Publik, miratuar me VKM nr.1, datë 10.01.2007, dhe me këtë Dokumentacion Tenderi.
- 2.2 Çdo operator ekonomik ftohet të dorëzojë ofertë. Kontrata do t’i akordohet atij Operatori Ekonomik që ka dorëzuar ofertën e vlerësuar si më e mira, bazuar në kriteret e përcaktuara në DT.
- 2.3 Në përputhje me Nenin 24 të LPP Autoriteti Kontraktor mund të anulojë procedurën e prokurimit për një nga arsyet e mëposhtme:
- 1) nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;
  - 2) asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit;
  - 3) të gjitha ofertat e pranuar përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e Autoritetit Kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;
  - 4) numri i ofertave të pranueshme që janë paraqitur është më i vogël se 2 (dy) dhe nuk sigurohet konkurrencë e mirëfilltë;
  - 5) për arsye të tjera të vërtetueshme, jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e botimit të procedurës së prokurimit, në emër të interesit publik;
  - 6) kur të gjitha ofertat e paraqitura rezultojnë anomalisht të ulta;

Të gjithë Operatorët Ekonomikë që kanë dorëzuar një ofertë ose kanë marrë pjesë në procedurë do të njoftohen për vendimin e marrë dhe arsyet për anulimin e procedurës së prokurimit brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

- 2.4 Termat e përdorur në Dokumentat e Tenderit kanë kuptimet e mëposhtme:

“Person(-a) i(të) Autorizuar” - person(a) të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor të veprojnë në emër të tij dhe person(a) të autorizuar me Prokurë të Posaçme, autorizim me shkrim ose me një mënyrë tjetër ligjore për të vepruar në emër të Ofertuesit.

“Autoriteti Kontraktor” – [*emri i autoritetit kontraktor*]

“LPP” - Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”.

“Procedura e Prokurimit” – procedurë e kryer nga Autoriteti Kontraktor, bazuar në këtë Dokumentacion Tenderi.

“Rregullat e Prokurimit Publik” – Aktet nënligjore të nxjera në zbatim të LPP, që përfshin veç të tjerave, Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.1, datë 10 .01.2007.

“Operatorë Ekonomikë” – çdo person fizik ose juridik, ose çdo grup personash të tillë, që ofron në treg furnizimin e mallrave.

“Ofertues” – çdo operator ekonomik që ka paraqitur një ofertë, në pajtim me DT.

“DT” – ky Dokumentacion Tenderi.

### **3. UDHËZIME PËR OPERATORET EKONOMIKE**

#### **Mënyrat e komunikimit me ofertuesit**

- 3.1 I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit (korrespondenca) ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomikë duhet të bëhet me shkrim, siç përcaktohet në Nenin 22 të LPP.
- 3.2 Në veçanti, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit kryhet nëpërmjet \_\_\_\_\_ (psh, postë, faks, mjete elektronike (në adresë interneti të përmendur në seksionin 2 të DT). Do të konsiderohet se korrespondenca është dorëzuar në kohën e duhur, nëse përmbajtja e saj, me shkrim, sipas nenit 22 të LPP, ka mbërritur tek Autoriteti Kontraktor para skadimit të afatit kohor.

#### **Hartimi i ofertës**

- 3.3 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të pranueshme.
- 3.4 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 3.5 Oferta dhe të gjithë dokumentat e korrespondenca që lidhet me ofertën, e shkëmbyer ndërmjet Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor duhet të përgatiten në gjuhën shqip/ose \_\_\_\_\_ (nëse është e zbatueshme). Materialet mbështetëse dhe literatura e printuar, që paraqitet nga Ofertuesi mund të jetë e shkruar edhe në një gjuhë tjetër që përdoret gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare, me kusht që këto dokumenta të shoqërohen me përkthimin e duhur në gjuhën e ofertës, të fragmenteve përkatëse.
- 3.6 (*opsion*).  
Një takim sqarues do të organizohet në \_\_\_\_\_ (dd/mm/vv) në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me DT dhe kërkesat e saj. Pjesmarrja është fakultative, por Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë takimit do t’u jepen informacione shtesë e shpjegime, të cilat do tu shpërndahen të gjithë Operatorëve Ekonomik. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me takimin duhet të mbulohen nga vetë ata. .

Për të organizuar takimin ju lutem kontaktoni: (përcaktoni personin e kontaktit)

3.7 Originali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me initiale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar. Për më tepër, në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomik, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit (Prokura mund të përfshijë edhe autorizimin për të nënshkruar një kontratë).

3.8 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formulari i Dorëzimit të Ofertës, në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojca 1 në DT;

b) Formulari i Deklarimit të Ofertës dhe Formulari i Çmimit të Ofertës, plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojcat 2 dhe 3 të DT.

c) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)

\_\_\_\_\_,  
\_\_\_\_\_,  
\_\_\_\_\_.

d) Dokumentat dhe vërtetimet e përmendura në Seksionin 4 të DT.

e) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

**Fshehtësia**

3.9 Neni 25 i Ligjit përcakton se:

“Pa çenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”

Autoriteti Kontraktor mendon se jo i gjithë informacioni i dorëzuar nga Ofertuesit do të jetë konfidencial. Një pjesë e informacionit, duke përfshirë edhe atë tregtar, financiar ose teknik do të jetë bërë tashmë publik ose do të bëhet publik në të ardhmen.

Autoriteti Kontraktor i kërkon Kandidatëve/Ofertuesve që në momentin kur dorëzojnë informacion pranë tij, të specifikojnë se cila pjesë e tij duhet të konsiderohet si e fshehtë, mbi ç’baza dhe për sa kohë duhet të ruhet si e tillë.

Në asnjë rrethanë çmimet e ofertave nuk mund të konsiderohen si konfidenciale/të fshehta.

Ofertuesi duhet të rendisë (në formatin e përcaktuar si Shtojca 12), atë pjesë të informacionit që duhet të ruhet i fshehtë dhe arsyet për të.

3.10 Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për furnizimin e \_\_\_\_\_ mallrave; Nr Kontratës \_\_\_\_\_

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA \_\_\_\_\_**

**(dd/mm/vv),**

**\_\_\_\_\_orës”.**

- 3.11 Ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t’i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Seksioni 3.10 i DT trajton pikërisht deklaratat e Ofertuesve lidhur me modifikimin ose tërheqjen e ofertave të tyre. Për më tepër, zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **“MODIFIKIM OFERTE”** ose **“TËRHEQJE OFERTE”**.

### **Llogaritja e çmimit**

- 3.12 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Dorëzimit të Ofertës dhe Formularin e Çmimit bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të levrohen, një pershkrim të shkurtër të mallrave, sasi të dhe çmimin e tyre.
- 3.13 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare dhe kursi i shkëmbimit duhet të jetë ai i fiksuar nga Banka Qëndrore e Shqipërisë në ditën kur publikohet njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhet në atë kurs shkëmbimi deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
- 3.14 Ofertuesi duhet të shënojë në Programin e Çmimit çmimet totale të ofertës të të gjitha Mallrave, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
- 3.15 Përveç kur Dokumentat e Tenderit e parashikojnë ndryshe, çmimet e dhëna nga Ofertuesi duhet të jenë të fiksuar përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t’i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm, dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktor si e papranueshme.

### **Afati kohor dhe vendi për dorëzimin e ofertave**

3.16 Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:

\_\_\_\_\_.

3.17 Afati kohor për dorëzimin e ofertave skadon më \_\_\_\_\_ (dd/mm/vv) në \_\_\_\_ ora. Ofertat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t'i rikthehen të pahapura Operatorëve Ekonomikë përkatës.

### **Data dhe vendi për hapjen e ofertave**

3.18 Hapja publike e ofertave do të kryhet më \_\_\_\_\_ (dd/mm/vv) në \_\_\_\_\_ ora, në \_\_\_\_\_ zyra \_\_\_\_\_. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre mund të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta në kohën e duhur.

### **Sigurimi i ofertës**

(OPSION)

3.19 Që një Operator Ekonomik të marrë pjesë në një procedurë prokurimi, kërkohet që të paraqesë Sigurimin e Ofertës, shoqëruar me Formularin e Sigurimit të Ofertës, që gjendet në Shtojcën 4. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është \_\_\_\_\_ Lekë (shuma e shprehur në fjalë : \_\_\_\_\_).

(OPSIONALE: nëse Autoriteti Kontraktor e ndan objektin e prokurimit publik në Lote)

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës për secilin nga Lotet është si më poshtë:

Loti 1 \_\_\_\_\_ Lekë

Loti 2 \_\_\_\_\_ Lekë

3.20 Sigurimi i Ofertës duhet të dorëzohet bashke me oferten para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

3.21 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare e pakushtëzuar,

b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet se bashku me oferten para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

3.22 Dokumentat e përmendur në pikën a – b) duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës të ofertës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

## **Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës**

- 3.23 Ofertat duhet të jenë të vlefshme [deri më \_\_\_\_\_] për 150 (ditë) që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Për sa kohë nuk ka skaduar afati kohor për vlefshmërinë e ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktor me shkrim, duhet të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës dhe të paraqesë një sigurim oferte të zgjatur. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk arrin t'i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk bën zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, ose nuk arrin të paraqesë një sigurim të zgjatur të ofertës, atëherë do të konsiderohet se Ofertuesi e ka refuzuar kërkesën e Autoritetit Kontraktor. Në këtë rast Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

## **4. PJESMARRJA DHE KUALIFIKIMI**

### **Kërkesat për kualifikim dhe vërtetimet e kërkuara**

- 4.1 Në përputhje me LPP, Operatorët Ekonomikë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për tu kualifikuar:
- Ofertat e tyre nuk duhet të refuzohen bazuar në nenin 45 të LPP;
  - ata duhet të gëzojnë të drejtën për të zhvilluar një aktivitet profesional dhe/ose për t'u regjistruar në regjistrat përkatës tregtarë ose profesionalë;
  - gjendja e tyre ekonomike dhe financiare duhet të garantojë ekzekutimin e duhur të kontratës;
  - aftësia e tyre teknike e profesionale duhet të garantojë një ekzekutim të përshtatshëm të kontratës.
- 4.2 Në përputhje me Nenin 45 të LPP, oferta do të refuzohet nëse Operatori Ekonomik:
- ka falimentuar ose po likujdon aktivitetin, ose ka hyrë në marrëveshje me kreditorët, ose ka pezulluar ose kufizuar aktivitetet e biznesit, ose është në një situatë të ngjashme, të shkaktuar nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve e rregulloreve përkatëse të Shqipërisë ose të shtetit të krijimit;
  - i është nënshtruar procedurave për deklarimin e falimentimit, për një urdhër të likuidimit të detyrueshëm ose për një marrëveshje me kreditorët, ose procedura të tjera të ngjashme, sipas ligjeve e rregullave përkatëse të Shqipërisë ose të shtetit të krijimit;
  - është dënuar për ndonjë shkelje lidhur me sjelljen e tij/të saj profesionale;
  - është gjykuar fajtor nga një gjykatë kompetente e Shqipërisë për sjellje të gabuar profesionale;
  - nuk i ka plotësuar detyrimet e tij lidhur me pagimin e kontributeve të sigurimit shoqëror, në përputhje me ligjet përkatëse të Shqipërisë ose të shtetit të krijimit;

f) nuk i ka plotësuar detyrimet e tij lidhur me pagimin e tatimeve, në përputhje me ligjet përkatëse të Shqipërisë ose të shtetit të krijimit;

g) keqinformon dhe dorëzon dokumenta, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi

4.3 Operatoret ekonomike duhet të jenë të regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor.

4.4 Operatorët Ekonomikë mund të vërtetojnë se nuk i përkasin asnjë prej rasteve të përmendura në seksionin 4.2 duke paraqitur provat e përshkruara në Shtojcën 5 të DT.

### **Kriteret Specifike të Kualifikimit**

4.5 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale: *(kërkesat më poshtë jepen vetëm si shembuj – autoriteti kontraktor mund të zbatojë një ose disa nga këto kërkesa apo mund të parashikojë kërkesa të tjera, me kusht që këto të jenë të sakta, objektive, jodiskriminuese dhe në përpjestim me vlerën e kontratës):*

1. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a. Furnizime të së njëjtës natyrë në një vlerë prej \_\_\_\_\_ lekë (një shumë jo më e lartë se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit;

b. Liçensa profesionale lidhur me mallrat objekt i kontratës nëse egzistojnë:

- .....
- .....
- .....

4.6 a. dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike *(për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor )*

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

b. dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

4.7 Vlerësimi i aftësive teknike e profesionale të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dëshmitë apo dokumentat e parashikuara në Shtojcën 5 të DT.

Përsa i përket kapacitetit ekonomik e financiare, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale *(kërkesat më poshtë jepen vetëm si shembuj – autoriteti kontraktor mund të zbatojë një ose disa nga këto kërkesa apo mund të parashikojë kërkesa të tjera, me kusht*

*që këto të jenë të sakta, objektive, jodiskriminuese dhe në përpjestim me vlerën e kontratës):*

1. xhiroja mesatare vjetore gjatë .....viteve të fundit (maksimumi tre) vjet duhet të ketë një vlerë jo më të lartë ..... lekë (vlera limit e kontrates),
2. *kërkesa të tjera të rëndësishme, nëse nevojiten.*

4.6 Vlerësimi i gjendjes ekonomike e financiare të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme (*përzgjidhni dokumentat ose deklaratat e kërkuara nga Operatori Ekonomik nga të mëposhtmet*):

- a) Kopje të vërtetuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse; (*jo më shumë se të tre viteve të mëparshëm*) dhe/ose;
- b) Kopje të deklaramit të xhiros vjetore dhe/ose të raporteve të manaxhimit financiar nga një organ i jashtëm i liçensuar për kontrollin financiar; (*jo më shumë se të tre viteve të mëparshëm*) dhe/ose;
- c) Një çertifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka (*nëse kërkohet një vlerë që nuk e tejkalon vlerën në kesh të nevojshme për të mbuluar koston fillestare të kontratës dhe në rastet kur nuk parashikohet asnjë pagesë paraprake*)

#### **Bashkimi i Operatoreve Ekonomike**

4.8 Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë ekzekutimit të kontratës. Në oferta duhet të përcaktohet pjesa e mallit që do të furnizojë secili nga anëtarët e këtij grupi.

4.10 Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht me anë të një marrëveshjeje të noterizuar, në të cilën tregohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes apo sasia e mallrave konkrete për secilin anëtar, si dhe autorizimi/prokurën për përfaqësimin e anëtarëve të grupit, si për dorëzimin e ofertës ashtu edhe për lidhjen e kontratës në rast të shpalljes fitues. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen si bashkim të operatorëve ekonomikë.

4.11 Në rastet e ofertave të paraqitura nga një bashkim shoqërisht, gjatë vlerësimit të plotësimit të kërkesave të përcaktuara në DT, Autoriteti Kontraktor merr parasysh kualifikimet, gjendjen ekonomike e financiare dhe aftësitë teknike e profesionale të këtij bashkimi të marrë së bashku. Dokumentat e përmendur në seksionet 4.2, 4.3 dhe 4.4 duhet të përgatiten veçmas për secilin anëtar të bashkimit dhe duhet t'i bashkangjiten ofertes. Nderkohe, kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të permbushen nga i gjithë grupi i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

**Nënkontraktimi (opsion)**

- 4.12 Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin, për realizimin e një pjese të kontratës. Nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40 % të vlerës së kontratës dhe mund të kufizohet në mallra të veçanta. Ofertuesi duhet të deklarojë nënkontraktorin e përzgjedhur gjatë deklarimit të ofertës. Nënkontraktori i përzgjedhur duhet të zotërojë kualifikimet e nevojshme për ekzekutimin e nënkontratës të cilat verifikohen nga Autoriteti Kontraktor përpara lidhjes së nënkontratës

### **Veprimet e jashtëligjshme**

- 4.13 Në përputhje me Nenin 26 të LPP, me legjislacion për parandalimin e konfliktit të interesit, dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktor e refuzon një ofertë, nëse ofertuesi që e ka paraqitur atë:
- i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të Autoritetit Kontraktor një dhuratë në kesh ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim, ose rrjedhën e procedurës së prokurimit publik; dhe/ose
  - është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si psh – një ofertues është i lidhur me një person fizik ose juridik, që është ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor të japë shërbime këshilluese gjatë përgatitjes së projekteve, specifikimeve ose dokumentave të tjerë lidhur me prokurimin, apo ka lidhje me anëtarë të komisionit të vlerësimit etj.
  - Ka dorëzuar dokumenta/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura në Seksionin 4 të DT.
- 4.14 Autoriteti Kontraktor e informon me shkrim Ofertuesin dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për refuzimin e kërkesës ose ofertës, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e prokurimit.

## **5. VLERËSIMI I OFERTAVE**

Ofertat do të vlerësohen në bazë të kritereve të mëposhtme.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka paraqitur ofertën e vlerësuar si më të ulët. Ato oferta që në thelb nuk pajtohen me përshkrimin teknik e objektit të prokurimit publik do të refuzohen.

*(OPSION: në rast se mallrat që duhet te levrohen janë komplekse ose, në raste të veçanta, kërkohen për një qëllim të veçantë),* Autoriteti Kontraktor ose një zyrë kompetente e vendit pranë së cilit është regjistruar Operatori Ekonomik, mund të kryejë kontroll në emër të autoritetit kontraktor, lidhur me kapacitetet teknike të Ofertuesit dhe, nëse është e nevojshme, lidhur me kapacitetet studimore, kërkimore dhe masat për kontrollin e cilësisë;

### **Kriteret e përzgjedhjes**

- 5.1 **(Opsioni 1)** Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.  
Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.  
**(Opsioni 2)** Oferta me vlerën më të ulët të vlerësuar.

(Çmimi, shërbimet pas shitjes dhe elementë të tjerë që kanë peshë ekonomike)

## Ndalimi i negociatave

- 5.2 Nuk do të kryhet asnjë negociatë me Ofertuesin në lidhje me ofertën e tij. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit të sqarojë ofertën e tij, pa bërë asnjë ndryshim në thelbin e saj.

## Ofertat anomalisht të ulëta

- 5.3 Nëse oferta e dorëzuar, bazuar në formulën e para-përcaktuar, i duket Autoritetit Kontraktor anomalisht e ulët në lidhje me mallrat e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të kënaqë Autoritetin Kontraktor, atëherë ai ka të drejtë të refuzojë ofertën.
- 5.4 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në kreun V pika 4(g) të RPP - oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur zbritja e saj nga vlera limit (në përqindje) është mbi një të pestën e mesatares aritmetike të zbritjeve të të gjitha ofertave të rregullta.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët është si më poshtë:

$F_L$  – Fondi Limit  
 $O$  – Oferta  
 $M_O$  – Mesatarja e Ofertave  
 $n$  – Numri i Ofertave  
 $Z_M$  – Zbritja e Mundshme

$$M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / n$$

$[F_L - M_O]$  – Diferenca e Fondi Limit nga Mesatarja e Ofertave

$$Z_M = [F_L - M_O] + 1/5 \times [F_L - M_O]$$

Nqs diferenca  $> Z_M$ , **si rrjedhim Oferta është Anomalisht me e Ulet**

- 5.5 Gjatë gjykimit nëse çmimi i një oferte është i justifikueshëm, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë me shkrim Ofertuesit që të paraqesë detaje të mëtejshme mbi ofertën, duke përfshirë këtu elementet e çmimit dhe përlllogaritje të detajuara. Autoriteti Kontraktor merr në konsideratë sqarime lidhur me, si më poshtë:
- aspektet ekonomike të procesit të fabrikimit/realizimit;
  - zgjidhjet teknike dhe/ose kushtet e jashtëzakonshme të favorizuara që janë në dispozicion të Ofertuesit, për ekzekutimin e shitjes së mallit;
  - originalitetin e mallrave të ofruara nga Ofertuesi;

d) pajtueshmërinë me dispozitat që lidhen me legjislacionin e punës, si kushtet e punës që janë në fuqi në atë vend ku realizohen blerjet/shitjet e mallit.

### **Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra**

- 5.6 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e pajis menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.
- 5.7 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, sipas shëmbujve të mëposhtme:
- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumat në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,
  - përveç kontratave me shumat të mëdha, nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumat në total,
  - nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet.
- 5.8 Autoriteti Kontraktor e konsideron një ofertë si të pranueshme, nëse ajo i plotëson kërkesat e parashikuara në njoftimin e kontratës dhe në DT. Pavarësisht nga sa u tha më lart, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'a quajë ofertën të pranueshme, nëse:
- (i) ajo përmban ndonjë gabim ose pakujdesi që mund të korrigjohen pa ndryshuar asnjë kusht ose aspekt material të kësaj oferte, ose që nuk ndikojnë në konkurrencë, ose
  - (ii) ajo përmban vetëm devijime të vogla që nuk e ndryshojnë materialisht ose që nuk lindin si pasojë e karakteristikave, kushteve dhe kërkesave të tjera të paraqitura në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit; megjithatë, me kusht që çdo ndryshim i tillë të matet sa më mirë të jetë e mundur, dhe të merret në konsideratë siç duhet gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave.
- 5.9 Sa herë që refuzohet një ofertë ose s'kualifikohet një ofertues, autoriteti kontraktor informon ofertuesin e interesuar mbi arsyen/t e s'kualifikimit ose refuzimit. Formulari i njoftimit gjendet në Shtojcën 6 të DT.

## **6. ANKIMI ADMINISTRATIV NË DISPOZICION TË OPERATORËVE EKONOMIK**

- 6.1 Çdo operator ekonomik që ka një interes ligjor në kontratat e prokurimit publik dhe beson se Autoriteti Kontraktor ka shkelur dispozitat e LPP dhe rregullat për PP gjatë procedurës në fjalë të shpalljes së kontratës fituese, ka të drejtë të kundërshtojë këtë procedurë. Gjatë bërjes së ankesës, pala e interesuar duhet të përdorë formularin e ankesës, që gjendet në Shtojcën 13 të DT.
- 6.2 Kundërshtimet duhet t'i paraqiten me shkrim Autoritetit Kontraktor brenda 5(pesë) ditëve pune nga dita kur ankimesi ka marre dijeni ose duhet të kishte marre dijeni për shkeljen e pretenduar.
- 6.3 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk arrin të shqyrtojë këtë kundërshtim brenda afateve limit kohorë të specifikuar në nenin 63 të LPP, ose e refuzon kundërshtimin, atëherë ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim pranë Agjencisë së Prokurimit brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e parë e punës pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në seksionin 6.2, ose, nëse kundërshtimi refuzohet në shkallë të parë nga Autoriteti Kontraktor, që nga dita kur ankimesi u informua nga Autoriteti Kontraktor për sa më sipër. Një kopje e këtij ankimi me shkrim duhet t'i njoftohet njëherazi edhe Autoritetit Kontraktor. Ankimesi duhet të përdorë të njëjtin formular standard për ankimin, siç parashikohet në seksionin 6.1. Formulari mund të shkarkohet pa kosto edhe në faqen e internetit të APP, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al). Ankesat duhet t'i drejtohen personit/zyrës (të plotësohet nga Autoriteti Kontraktor) adresa, fax,tel.
- 6.4 Njëherazi, nëse dëshirohet një gjë e tillë, pala e interesuar mund të dorëzojë një kopje të ankesës drejtpërdrejt pranë Zyrës së Avokatit për Prokurimet Publike.

## **7. NËNSHKRIMI I KONTRATËS**

- 7.1 Autoriteti Kontraktor e informon atë Ofertues, oferta e të cilit është përzgjedhur si më e mira, përmes dërgimit të njoftimit të shpalljes fitues, siç parashikohet në Shtojcën 7. Një kopje e zgjeruar e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP.

### **Sigurimi për ekzekutimin e kontratës (OPSION)**

- 7.2 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, që është i bashkangjitur si Shtojca 12 e DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.
- 7.3 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
- i. garanci bankare e pakushtëzuar,
  - ii. garanci sigurimi,
- 7.4 Në pajtim me Rregullat për PP, pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor dërgon një njoftim në APP për Publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

### **Kushtet e kontratës**

- 7.5 Autoriteti Kontraktor do të firmosë me atë Ofertues, oferta e të cilit është përzgjedhur si oferta me çmimin më të ulët për kontratën e [\_\_\_\_\_] [për një Lot të caktuar], \_\_\_\_\_.
- 7.6 Drafti i kontratës përfshihet si Shtojca 8 dhe Shtojca 9 e këtij Dokumentacioni Tenderi (“Drafti”). Ofertuesi duhet të plotësojë draftin me të dhënat dhe detajet e tij, që gjenden në Ofertë (psh, çmimi).
- 7.7 Drafti i Kontratës (kushtet e vecanata dhe të përgjithshme), në rast të shpalljes fitues, plotësohet nga Ofertuesi duke e firmosur në çdo faqe të tij nga Personat e Autorizuar. Në Formularin e Deklarimit të Ofertës, Ofertuesi konfirmon pajtimin e tij për të firmosur kontratën sipas formularit të Kushteve të Kontratës, (shtojcat 9 dhe 10).

### **Garancia dhe detyrime të tjera të Ofertuesve**

*[PLOTËSONI, siç DUHET]*

- 7.8 Ofertuesi është i detyruar të paraqesë një garanci për mallrat e ofruara. Periudha e garancisë duhet të specifikohet në Ofertë.

## **8. INFORMACION MBI DOKUMENTACIONIN E TENDERIT**

- 8.1 Tarifa për DT është \_\_\_\_\_ lekë. Kjo tarifë mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomik të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.
- 8.2 Operatorët ekonomikë mund të ankimojnë ose të kërkojnë sqarime me shkrim të DT nga Autoriteti Kontraktor, në kohë të përshtatshme dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë para datës së fundit për dorëzimin e ofertave.
- 8.3 Autoriteti Kontraktor përgatit një përgjigje me shkrim, duke ruajtur parimet themelore të konkurrencës për procedurën e prokurimit, që duhet t’i shpërndahet të gjithë kandidatëve ose ofertuesve, jo më vonë se 3 (tre) ditë pas marrjes së kërkesës. Nëse përgjigjia mund të kërkojë ndryshime në DT, atëherë Autoriteti Kontraktor, sipas Nenit 42 të LPP, e zgjat afatin kohor të LPP për dorëzimin e ofertës, me 5 dite për prokurimet me vlere nën kufijte e larte monetare monetare dhe me 10 dite për prokurimet me vlere mbi kufijte e larte monetare, në përputhje me nenin 42 të LPP-se së ndryshuar..
- 8.4 Autoriteti Kontraktor mund të ndryshojë në çdo kohë Dokumentacionin e Tenderit, me kusht që të gjitha ndryshimet t’i vihen në dispozicion operatorëve ekonomikë të interesuar në të njëjtën ditë dhe jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para datës së përcaktuar si

afati limit për dorëzimin e ofertave. Çdo ndryshim i kryer do të jetë pjesë përbërëse e Dokumentacionit të Tenderit.

Shenim: Autoritetet kontraktore nuk duhet të nderhyjnë për të bërë asnjë lloj plotësimi ose ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 2 në pikën 8.  
Te gjitha plotësimet do të bëhen tek shtojcat.

## **9. SHTOJCAT**

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

- Shtojca 1: Formulari i Dorëzimit të Ofertës
- Shtojca 2: Formulari i Deklarimit të Ofertës
- Shtojca 3: Formulari i Çmimit të Ofertës
- Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 5: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
- Shtojca 6: Formulari për Njoftim S'kualifikimi
- Shtojca 7: Formulari i Njoftimi të Fituesit
- Shtojca 8: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Shtojca 9: Kushtet e Vecanta të Kontratës
- Shtojca 10: Njoftim i Nënshkrimit të Kontratës
- Shtojca 11: Formulari i Informacionit Konfidencial
- Shtojca 12: Formulari i Sigurimit të Kontratës
- Shtojca 13: Formulari i Ankesës për Prokurimin
- Shtojca 14: Specifikimet teknike
- Shtojca 15: Sasia e mallrave, dhe kushtet e lëvrimit

**Shtojca 1**

**FORMULARI I DORËZIMIT TË OFERTËS – MALLRA**

Titulli i kontratës dhe numri i referencës: .....

Njoftimi i Kontratës: .....

*(Vendi dhe Data)*

PËR: *(Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor)*

-----

DORËZUAR NGA

**Emri (-at) e ofertuesit (-esve)**

**Përfaqësuesi \***

**Partneri 2\***

**Etj ... \***

\* Shto/fshi rreshta të tjerë për partnerë, nëse nevojitet. Vini re se nënkontraktori nuk konsiderohet partner në këtë procedurë tenderi. Nëse kjo ofertë dorëzohet nga një ofertues individual, atëherë emri i tij duhet të regjistrohet si **Drejtues** (dhe të gjithë rreshtat e tjerë duhet të fshihen)

**Nr. i fleteve te dorezuara \_\_\_\_\_ (flete)**

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**

**Emri:**

**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**

**Faks:**

**E-mail:**

**Nenshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 2

[ *Letër me kokë e ofertuesit* ]

### FORMULARI I DEKLARIMIT TË OFERTËS

[ *Ref. ...* ]

[ *Data* ]

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit ( *nëse zbatohet* ): [ *referenca e dosjes, përcaktuar sipas autoritetit kontraktor* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *lloji i procedurës dhe objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimit Publik [ *Data* ] [ *Numri* ]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Kemi shqyrtuar dokumentat e tenderit për këtë procedurë dhe pranojmë, pa rezerva e përjashtime, kërkesat, afatet kohore dhe kushtet, e shprehura në këto dokumenta;
2. Ne i përmbushim të gjitha kërkesat ligjore, financiaro-ekonomike dhe teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta, të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë;  
( *në rast të procedurës së kufizuar ose me negociim, për fazën e kualifikimit* )
3. Ne shprehim interes për të marrë pjesë në procedurë, në rast përzgjedhjeje nga autoriteti kontraktor;  
( *në rastin e tenderit të hapur/procedurës së kufizuar ose me negociim gjatë fazës së ofertimit dhe me kriterin e çmimit më të ulët* )
4. Çmimi total i ofertës sonë është [ *monedha dhe vlera e ofertës* ]; pa TVSH;
5. Çmimi total i ofertës sonë është [ *monedha dhe vlera e ofertës* ]; me TVSH  
( *në rast të tenderit të hapur/procedurës së kufizuar ose me negociim gjatë fazës së ofertimit dhe me kriterin e ofertës me avantazhe më të mëdha ekonomike* )
6. Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në dokumentat e tenderit;
7. Në rast se oferta jonë pranohet, ne do të bëjmë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit;

8. Nuk do të marrim pjesë si ofertues me më shumë se një ofertë për këtë procedurë.
9. Ne autorizojme autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/ dokumentet, që i bashkëlidhen kesaj oferte.
10. Pajtohem për të firmosur kontratën sipas formularit të kushteve të kontratës nëse shpallej fitues.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nenshkrimi

Vula

**Shtojca 3**

**FORMULARI I ÇMIMIT TË OFERTËS**

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>
<b>Puna nr</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi Njësi</b>	<b>Çmimi Total</b>	<b>Afati</b>
<b>Çmimi Neto )</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi Total</b>					

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Shënim:

1. Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Shqiptare (Lekë).

#### Shtojca 4.

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Ref. ...]

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [lloji i procedurës dhe objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Prokurimit Publik [Data] [Numri]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është percaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së percaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

## Shtojca 5

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është në proces falimentimi, lëshuar nga Qendra Kombëtare të Regjistrimit
2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, lëshuar nga Qendra Kombëtare të Regjistrimit.
3. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional, lëshuar nga Qendra Kombëtare të Regjistrimit.
4. Një dokument që vërteton se kapitalet/asetet e (subjektit tuaj) nuk janë në duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit.
5. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore.
6. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kritere (pikat 1-6) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë ato kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar në përputhje me seksionin 4 të DT, ofertuesi duhet të paraqesë:

*(të plotësohet nga autoriteti kontraktor, në pajtim me kërkesat e parashikuara në Seksionin 4 të DT) –*

-Kopje të bilancit per 2007.

- Një çertifikatë të gjendjes financiare jo me pak se 20% te kontrates qe do te realizohe nga nje ose me shume banka (te marre jo me pare se 1 muaj nga data e tenderit).

- Vertetim per xhiro mesatare vjetore gjatë vitit 2007 e cila duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se vlera qe prokuron .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 6**

Draft

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike, nr. 9643 datë 20.11.2006, i njohur si LPP<sup>1</sup>.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u [s'kualifikuat] [eliminuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme [*shënoni kutinë e duhur*]:

[subjekti juaj] [drejtuesi juaj ekzekutiv]

- mori pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës, ose dosjen e tenderit, ose pjesë të tij, që u përdorën nga autoriteti kontraktor
- mori asistencë të paligjshme në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose një pjesë të saj

[subjekti juaj]

- Është gjykuar nga një gjykatë që gëzon juridiksionin kompetent se ka kryer një shkelje kriminale ose civile, që përfshin praktikën korruptive, pastrimin e parave, organizimin

---

<sup>1</sup> Ky njoftim i adresohet ofertuesve i) që janë s'kualifikuar në bazë të Nenit 45, 46 dhe 47 të LPP; ii) oferta e të cilëve është refuzuar për shkak se ata nuk arritën të plotësonin kërkesën për sigurimin e ofertës.

kriminal ose aktivitetet e përshkruara në Nenin 45 të LPP, në ligjet ose rregullat e zbatueshme në Shqipëri, ose sipas marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare;

- Një gjykatë me jurisdikcion kompetent ka vendosur se ka kryer një veprim mashtrimi ose një veprim të njëvlershëm me mashtrimin;
- Është dënuar nga një gjykatë me juridikcion kompetent, për sjellje të gabuar profesionale;
- Është në ndjekje penale për një nga veprat penale të përshkruara në nenin 45 të LPP;
- ka falimentuar, aktiviteti është marrë nën administrimin e gjykatës, në përputhje me nenin 45, 2(b) të LPP;
- është nën procedurën e deklarimit të falimentimit, sipas një urdhri për likuidim të detyruar ose administrim nga gjykata, ose sipas një marrëveshjeje me kreditorët, ose sipas procedurave të ngjashme, në pajtim me nenin 45, 2(c) të LPP;
- është dënuar me vendim të formës së prerë për shkelje lidhur me sjelljen profesionale;
- nuk ka paguar kontributet e sigurimit shoqëror, në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;
- nuk ka përmbushur detyrimet lidhur me pagimin e tatimeve, në përputhje me Ligjin Shqiptar ose me dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;

**Nuk arritët të paraqisni:**

- Çertifikatat ose vërtetimet e kërkuara që tregojnë se ju nuk jeni në kushtet e Nenit 45 të LPP,
- Një çertifikatë, dokument ose vërtetime të tjera të mjaftueshme që kërkohen nga autoriteti kontraktor sipas Nenit 46 të LPP dhe (*seksionet përkatëse të DT*), me qëllim verifikimin e përshtatshmërisë suaj profesionale;
- Vërtetime të mjaftueshme, siç përshkruhen në Nenin 46 të LPP dhe (*seksionet përkatëse të DT*), që tregojnë se kandidati ose ofertuesi në fjalë i plotëson kërkesat për kapacitetet minimale financiare, teknike dhe profesionale, të specifikuar në dosjen e ofertës ose në njoftimin e kontratës;
- Autoriteti Kontraktor ka vendosur se ju keni dorëzuar dokumenta që përmbajnë informacion të rremë ose dokumenta të falsifikuar, me qëllim kualifikimi;
- Oferta juaj [nuk i përgjigjet kërkesave] [është e parregullt] [është anomalisht e ulët];
- Nuk arritët të plotësonit kërkesat për sigurimin e ofertës;
- (ndonjë shkak tjetër përvec atyre më sipër)

JUSTIFIKIMI

Dokumentat Standarde të Tenderit

---

[Jeni s'kualifikuar] [oferta juaj u refuzua] për shkak të këtyre arsyeve, si më poshtë:

[*Shënoni arsyet e hollësishme për s'kualifikimin ose refuzimin e ofertës në fjalë*]

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP dhe seksionin 6 të DT.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

**Shtojca 7**

[Autoriteti Kontraktor]  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Ref. ...]

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

\* \* \*

Procedura e prokurimit: [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjale)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjale)

Etj. \_\_\_\_\_

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it Perkatesisht per arsyet e

meposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 8.

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur**

#### **Neni 1: Qellimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Entit prokurues dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe rrisqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktor.
- 2.4 “ Lëvrimi ” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gazshme.
- 2.9 “Shërbimet në Lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose te paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse osë detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarte Teknike” do të thote specifikimet e aprovuara nga një trup i posacëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikata e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake më shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron materialet.

**Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmeria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçem të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në pajtim me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

**Neni 9: Përshtatshmeria e Mallrave me Standartet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet perkatese ose ne Standartet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër të kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standart Teknik perkates në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare te tanishme. Nëse nuk egzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike perkatese Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktues me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitesi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjesi per defekte te prones (Mallrave) per te cilat Autoriteti Kontraktor ishte ne dijeni ne momentin e lidhjes se kontrates ose nuk ishte ne dijeni per faj te tij, me perjashtim te rastit kur defektet kane te bejne me cilesine e Mallrave te specifikuar sipas kontrates ose perfaqsimin e reklames se shitesit (Kontraktuesit).

### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

- 10.1 Në se kontrata parashikon, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e dhëna një sasi pjesësh këmbimi, në akordim me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë perkatese të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të nderprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor në kohë të mjaftueshme për të lejuar Autoritetin Kontraktor të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japi gratis Autoriteti Kontraktor në se ai kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirmbajtjen e Mallrave.

### **Neni 11: Ambalazhimi**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në pajtim me kontratën në se ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, në se mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

### **Neni 12: Testimet dhe Inspektimet**

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të bie dakort të ndryshojë grafikun e levrimit.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 As egzekutimi i testeve as inspektimi i Mallrave nuk do ta clirojë Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

### **Neni 13: Kushtet e Dorëzimit**

- 13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit me përjashtim kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.
- 13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve në Lidhje me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
- 13.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.
- 13.5 Kontraktuesi është i detyruar t'i japi Autoriteti Kontraktor njoftim të arsyeshëm për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

### **Neni 14 Transportimi i Mallrave**

- 14.1 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kërkohet me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuar në kontratë.
- 14.2 Në se Enti prokurues është i detyruar të marrë Mallrat nga ndonjë mjet transporti apo agjenci transporti, Kontraktuesi duhet të japë lajmërim paraprak të arsyeshëm për transportin dhe t'i japi Entit prokurues të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave.
- 14.3 Në se shitësi, [Kontraktuesi] është i detyruar t'i dorëzojë mallrat në mjetin e transportit në një vend të specifikuar në kontratë, rrishti i humbjes kalon tek Autoriteti Kontraktor vetëm kur mallrat i dorëzohen mjetit të transportit në vendin e specifikuar. Fakti se shitësi [Kontraktuesi] është i autorizuar të mbajë dokumentat përfaqesues të mallrave nuk influencën në kalimin e rrishtit.

**Neni 15: Siguracioni**

- 15.1 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, Kontraktuesi duhet të sigurojë se Mallrat që do dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit gjatë transportit, magazinimit ose dorëzimit të tyre.

**Neni 16: Egzaminimi dhe Pranimi i Mallrave**

- 16.1 Përpara pranimit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të egzaminojë, inspektojë dhe testojë Mallrat. Ky aktivitet duhet të bëhet menjehere pas dorëzimit të Mallrave. Kontraktuesi ka të drejtë të marrë pjesë në këtë aktivitet dhe të shqyrtojë raportet e aktivitetit të pregatitura nga Autoriteti Kontraktor ose agjentët e tij.
- 16.2 Autoriteti Kontraktor duhet të pranojë ose refuzojë Mallrat menjehere pas dorëzimit dhe duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për veprimin e tij për të pranuar ose refuzuar Mallrat.

**Neni 17: Garancitë**

- 17.1 Kontraktuesi garanton se Mallrat janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se ato trupëzojnë përmirsimet e fundit në skicim dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.
- 17.2 Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje që egziston në momentin kur rrisu kaloi tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas këtij momenti.
- 17.3 Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për mosperputhjen që verifikohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm dhe që vjen nga mospërmbushja e ndonjë detyrimi, duke përfshirë garancinë që Mallrat duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e tyre të zakonshëm dhe specifik për një periudhë të caktuar kohe, ose se ato do të ruajnë cilësitë dhe karakteristikat e caktuara.
- 17.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë ose nga ligji, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën e tij për të kundërshtuar për të metat e sendit në se ai nuk i denoncon ato të shitësi (Kontraktuesi), duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditësh nga zbulimi i tyre.
- 17.5 Autoriteti Kontraktor duhet t'i sigurojë Kontraktuesit të gjitha mundësitë e arsyeshme për Kontraktuesin për të inspektuar këto defekte.
- 17.6 Pas marrjes së këtij njoftimi, Kontraktuesi duhet të riparojë menjehere ose të zëvendësojë Mallrat defektive ose pjesët e tyre gratis për Autoritetin Kontraktor.
- 17.7 Në se pas marrjes së njoftimit, Kontraktuesi dështon në rregullimin e defektit brenda një periudhe të arsyeshme, Autoriteti Kontraktor mund të procedojë, me shpenzimet e Kontraktuesit, të ndërmarrë veprime për rregullimin e nevojshëm.
- 17.8 Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit në se ai nuk e ushtron të drejtën e tij brenda dy vjetësh nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk bie në kundërshtim me kohezgjatjen e garancisë kontraktore.

- 17.9 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mund të shfrytëzojë rregullat e parashikuara ketu në se defektet kanë të bëjnë me fakte të njohura prej tij ose që nuk mund të ishin të panjohura për të dhe që nuk i janë vënë në dukje Autoritetit Kontraktor.

**Neni 18: Çmimi i Kontratës**

- 18.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 18.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe tarifën, duke përfshirë taksat dhe tarifën doganore të lidhura me dorëzimin e Mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, instalimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualët dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar dhe të nevojshme për përdorim të rrëgullt, mirmbajtje dhe riparime të Mallrave. Çmimi i taksave dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas ligjeve në fuqi 28 ditë para hapjes së ofertave.

**Neni 19: Afatet e Pagesës**

- 19.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 19.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për botimin të njoftimit të kontratës.
- 19.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit Kontraktor me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan Mallrat e dorëzuara dhe shërbimet e kryera.
- 19.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për Mallrat do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar Mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë.
- 19.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

**Neni 20: Vonesa në Bërjen e Pagesës**

- 20.1 Shperblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamatën e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.
- 20.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitorin (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.
- 20.3 Nëse kontrata parashikon transportim periodik ose në grup të Mallrave dhe pala kontraktuese nuk ka paguar për transporte të mëparshme, Kontraktuesi ka të drejtë të ndalojë transportin e grupeve të tjera deri sa të paguhet duke përfshirë edhe interesin e fituar.

**Neni 21: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

21.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 22: Forca Madhore**

22.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

22.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

22.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 23: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

23.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

23.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë.

23.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

23.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

23.5 Autoriteti Kontraktor mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë me përpikmëri Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

**Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar**

- 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore::
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
  - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total I kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates. .
  - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

**Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet**

- 25.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 25.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoriteti Kontraktor.
- 25.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 26: Ndryshimi i Porosisë**

- 26.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Mallra ose Shërbime shtesë deri në një madhësi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente më rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

**Neni 27: Ndërprerja për Mosplotësim**

- 27.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
  - Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 27.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

**Neni 28: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

- 28.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.
- 28.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

**Neni 29: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

- 29.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 29.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 29.3 Autoriteti kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Mallrat e pranuar dhe Shërbimet në Lidhje me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve në Lidhje me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

### **Neni 30: Nënkontraktimi**

- 30.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.
- 30.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritet Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 30.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për mallrat që do të furnizojë.
- 30.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

### **Neni 31: Transferimi i të Drejtave**

- 31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Entit prokurues.

### **Neni 32: Sigurimi i Kontrates**

- 32.1 Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japi Autoriteti Kontraktor garancinë e sigurimit të kontrates në shumën dhe formën e pranueshme siç specifikohet në kontratë. Dështimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe sekuestrimin e sigurimit të ofertes të Kontraktuesit.
- 32.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 32.3 Garancia e sigurimit të kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimit të Mallrave. Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbyshjen e kënaqshme të detyrimeve të kontrates.

### **Neni 33: Baza Ligjore**

33.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 34: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

34.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

34.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislationit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 35: Përfaqsimi i Palëve**

35.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

35.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

35.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

**Neni 36: Lajmërimet**

36.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

36.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 37: Llogaritja e Afateve**

37.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Shtojca 9

**KUSHTET E VEÇANTA**  
**Mallrat – Procedure e Hapur**

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

**Neni 1: Përkufizime**

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është \_\_\_\_\_
- 1.2 Kontraktuesi është \_\_\_\_\_

**Neni 2: Sigurimi i Kontrates**

- 2.1 Sigurimi i Kontrates në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i Kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

**Neni 3: Fillimi i Zbatimit**

- 3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë më \_\_\_\_\_. Nëse data nuk është e percaktuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

**Neni 4: Inspektimet dhe Testimet**

- 4.1 Inspektimet dhe testimet para pranimit të Mallrave do të bëhen: \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

**Neni 5: Kushtet e Dorëzimit**

- 5.1 Data (t) dhe vendi (et) i dorëzimit të Mallrave dhe pjesëve të kembimit do të bëhet sipas Grafikut të Levrimit të parashikuar në këtë kontratë.
- 5.2 Kontraktuesi duhet të njoftojë Entin prokurues \_\_\_\_\_ ditë para çdo dorëzimi të Mallrave.
- 5.3 Lajmërimi i dorëzimit duhet të bëhet me shkrim, faks, poste, e-mail etj, tek: \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

- 5.4 Në se Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, lajmërimi i dorëzimit duhet të përfshijë listën e dokumentave të nevojshme për marrjen e Mallrave dhe të tregojë se ku dhe kur do t'i jepen dokumentat Autoriteti Kontraktor.
- 5.5 Nëse Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, Kontraktuesi duhet të dorëzojë të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave tek: \_\_\_\_\_
- 

**Neni 6: Kushtet e Pagesës**

- 6.1 Pagesa e Mallrave duhet bërë brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga data e pranimi të Mallrave ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim të pagesës, sado vonë që të vije. Nëse nuk është specifikuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.
- 6.2 Monedha e pagesës do të jetë \_\_\_\_\_. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

**Neni 7. Pagesa Paraprake**

- 7.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë \_\_\_\_\_. Nëse nuk është specifikuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 7.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.
- 7.3 Në se jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: \_\_\_\_\_
- 

**Neni 8. Shërbimet në Lidhje me to**

- 8.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të Lidhura
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

**Neni 9. Zbritja e garancisë së kontratës**

- 9.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

## Shtojca 10

### FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: \_\_\_\_\_

Nr. i Referencës së Kontratës: \_\_\_\_\_

Kjo Kontratë është lidhur më [data], midis [emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor] tani e tutje të referuar si “Autoriteti Kontraktor” dhe [emri dhe adresa e Kontraktuesit] të përfaqësuar nga [përfaqësuesi], tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi”.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për furnizimin e mallrave, duke i'u referuar Prokurimit nr. \_\_\_\_\_

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [data] bie dakord të furnizojë mallrat, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- këtë Formular Kontrate
- Formulari i Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej \_\_\_\_\_ për furnizimin e mallrave;

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: \_\_\_\_\_ dhe në formën e: \_\_\_\_\_, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.
2. Kontraktuesi është i detyruar të furnizojë për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për mallrat e levruara, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.

Dokumentat Standarde të Tenderit

---

4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_/ palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

Autoriteti Kontraktor

Kontraktuesi

---

---

---

Emri dhe firma e Përfaqësuesit

---

Emri dhe firma e Përfaqësuesit

Vula:

Vula:

**Shtojca 11**

**FORMULARI I PUBLIKIMIT TE NJOFTIMIT TE KONTRATËS SE  
NËNSHKRUAR**

**Seksioni I      Autoriteti Kontraktor**

**I.1      Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Adresa në Internet \_\_\_\_\_

**I.2      Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:**

Institucion Qëndror	Institucion i Pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njesite e Qeverisjes Vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**Seksioni II      Objekti i Kontratës**

**II.1      Lloji i Kontratës**

Punë	Shërbime	Mallra
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**Lloji i “Kontratave për Punë Publike”**

Realizimi i Puneve	Projektimi dhe realizimi i puneve
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**Lloji i ‘Kontratave Publike për Shërbime’**

Konkurs Projektimi	Shërbime Konsulence	Shërbime të tjera
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**Lloji i “Kontratave Publike për Mallra”**

Blerje	Qira	Leasing	Blerje me këste	Një kombinim i tyre
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

(Sasitë dhe synimi i kontratës, si dhe fondi limit)

---

---

---

**II.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në muaj  ose ditë

ose

duke filluar nga // me përfundim në //

**II.4 Ndarja në LOTE:**

Po  Jo

Nëse Po, numri i LOTEVE:

**II.5 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka):

ose: nga  në .

**Seksioni III Procedura**

**III.1 Lloji i procedurës:**

E hapur	E kufizuar	Me negociim	Konkurs projektimi
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

*Në rast të procedurës me negociim:*

Justifikimi për përzgjedhjen e procedurës me negociim, pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës:

---

---

---

**III.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) çmimi më i ulët

ose

B) oferta ekonomike  më e ulët e vlerësuar

lidhur me rëndësinë: Çmimi  ose Cilësia , etj

**III.3 Numri i ofertave të dorëzuara:**  **Numri i ofertave të rregullta:**

**III.4.Referenca e dosjes, e përcaktuar sipas autoritetit kontraktor:**

\_\_\_\_\_

#### **Seksioni IV Informacion mbi kontratën**

**IV.1 Numri i Kontratës:** \_\_\_\_\_ **Data e Kontratës**  
//

#### **IV.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Adresa e Internetit \_\_\_\_\_

#### **IV.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet dhe opsionet):**

Vlera \_\_\_\_\_ (pa TVSH) Monedha \_\_\_\_\_  
Vlera \_\_\_\_\_ (me TVSH) Monedha \_\_\_\_\_

#### **IV.4 Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtën kontratë (nëse zbatohet):**

Buletini i Njoftimeve Publike Data \_\_\_\_\_ Numri \_\_\_\_\_

#### **V.4 Informacione shtesë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi □□/□□/□□□□

**Shtojca 12**

**LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL**

(Shënoni më poshtë informacinin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

### Shtojca 13

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

#### **FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

[Ref. ...]

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): [referenca e dosjes, përcaktuar sipas autoritetit kontraktor]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [lloji i procedurës dhe objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Prokurimit Publik [Data] [Numri]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve] në një shumë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [emri i autoritetit kontraktor]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 14**

**FORMULARI I ANKESËS PËR PROKURIMIN**

**Ankesë drejtuar:** *Autoriteti Kontraktor*

**Ankesë drejtuar:** *Agjencia e Prokurimit Publik*

*(Shënoni një nga kutitë)*

**Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqëror).*

---

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

---

Adresa

---

Qyteti

---

Shteti

---

Kodi Postar/Kodi Zip

---

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

---

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

---

E-mail

---

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

---

Firma e zyrtarit të autorizuar

---

Data (viti/muaji/dita)

---

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

---

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

## Seksioni II. Informacion për Procedurën

### 1. Numër Identifikimi

*Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

---

### 2. Autoriteti Kontraktor

*Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

---

### 3. Vlera e Përlogaritur e Prokurimit

*Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)*

---

### 4. Objekti i Kontratës

*Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.*

---

### 5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

*Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.*

---

Data (viti/muaji/dita)

### 6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

---

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

## Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

### 1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)



**2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve**

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*



**Seksioni IV. Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktor**

*Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejtpërdrejt autoritetit kontraktor. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.*

1. **Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (psh, me shkrim, nepermjet faksit, etj).**

Po  Jo

---

2. **Autoriteti kontraktor Pranë të Cilit është bërë Kundërshtimi**

*Emri i autoritetit kontraktor.*

---

*Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.*

---

3. **Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese**

*Çfarë mase korrigjuese kërkoni?*

---

4. **Lista e Shtojcave**

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë. Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: **Agjencisë së Prokurimit Publik.**

Një kopje e kësaj ankese duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit kontraktor.

**Nr. Faks:**

**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit**



**Shtojca 16**

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Sasia e mallit që kërkohet:

<b>1 gjenerator 10 Kw</b>	<b><u>Sasia</u> 1-cope</b>
---------------------------	--------------------------------

Afatet e lëvrimit:

**Brenda 1 muaji nga data e lidhjes se kontrates.**